

Data: 21/11/2022

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: "Ndërtim i Kuartallit të Ri në Varrezat e Qytetit"

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punë ndërtimore kod 45

VLERA E FONDIT LIMIT:

5,657,870 (pesë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH, për procedurën me objekt "Ndërtim i Kuartallit të ri në Varrezat e Qytetit", vënë në dispozicion nga Të ardhurat Lokale 2022-2023.

Për vitin 2022 Financimi do të jetë në vlerën 5,000,000 (pesë milion) lekë me Tvsh.

Për vitin 2023 Financimi do të jetë në vlerën 1,789,444 një milion e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e dyzetë e katër) lekë me Tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor Bashkia Patos ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8,

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe nenit

(Shënim: *përcaktoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit apo nevojën që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës).*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1.Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019,2020,2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **5,657,870 (pesë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë) lekë**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Fondi Limit: 5,657,870 (pesë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë) lekë

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me

sukses kontraten. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontraten

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020,2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar.

2.2.3. Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2022.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, njësitë e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2022 sipas kësaj, prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për

të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë si dhe dokumentat e mëposhtëm:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ii. Situacion përfundimtar të objektit,*
- iii. Aktin e Kolaudimit të objektit,*
- iv. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës nr.9*

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve si dhe dokumentat e mëposhtëm:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ii. Situacion përfundimtar të objektit,*
- iii. Aktin e Kolaudimit të objektit,*

(Shënim: të përcaktohen dokumentet konkrete që kërkohen për të dëshmuar përvojën e mëparshme të ngjashme me sektorin privat, të cilat janë të nevojshme dhe i shërbejnë AK për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 30% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm,

ose jo më e vogël se vlera e fondit limit , për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

$$5,657,870 \times 30\% = 1,697,361$$

Shënim: *(Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi).*

2.3.2 Liçensat profesionale të shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës , referuar preventivit të punimeve si dhe llojit të punimeve të parashikuara në të duhet të ketë këto pika në licencën profesionale , Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Energji, në bazë të VKM Nr 42 dt 16.01.2008 i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- a. NP-1: Punime germimi në tokë "Kategoria A".
- b. NP-2: Ndërtime civile dhe industriale "Kategoria A".
- c. NP-4: Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale "Kategoria A".
- d. NS-4: Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese "Kategoria A".
- e. NS - 18 Punime topogjeodezike "Kategoria A".

Në rast bashkimi operatorësh secili duhet të disponojë kategoritë e licencës sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

- **NP-1: Punime germimi në tokë** "Kategoria A"

Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

- **NP-2: Ndërtime civile dhe industriale** "Kategoria A"

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazërma ushtrie, teatro, stadiume, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të parandëruar, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.

➤ **NP-4: Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale** **“Kategoria A”**

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt.

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo vepre lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

➤ **NS-4: Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese** **“Kategoria A”**

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

➤ **N.S - 18 Punime topogjeodezike** **“Kategoria A”**

Konsiderohet zbatimi i rëlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë	Vlera e punimeve që parashikohen të

				respektive	kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime germimi ne toke	3.87/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , toke zak, kategoria III	Kategoria A	< 20 mil
		3.47/1b	Mbushje, rafshim,ngjeshje me tokmak elektrik, cdo 30 cm, toke te zakonshme		
		3.4	Prerje e sistemim pemesh ø 21 - 40 cm		
		2.37/1a	Transport materiale ndertim, dheu me auto deri 1.0 km		
NP-2	Ndërtime civile dhe industriale	2.28/a	Germim themele e plinta b~2m, ekskavator me zinxhir 0.25m ³ ,shkarkimi ne auto	Kategoria A	< 20 mil
		3.243	Struktura monolite betoni C 16/20 (mure)		
		2.167	F V hekur betoni periodik Ø > 10 mm		
		2.166	F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm		
		2.258	Nenshtrese zhavori ne themel		
		An-8	Mbushje me cakell (15 cm pas mureve)		
		3.240	Struktura monolite betoni C 12/15 (per shkallet)		
NP-4	Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale	2.288	Trotuar me pllaka granili me boje pa borduren e betonit	Kategoria A	< 20 mil
		2.261	Shtrese rere per fugat e trotuarit		
		3.616	F V bordura betoni 12x25 cm		
		2.262/1	Shtrese betoni C 7/10 t=5 cm + nen bordure		
		2.258	Nenshtrese zhavori t=10cm		

NS-4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese	2.28/a	Germim themele e plinta b~2m, ekskavator 0.25m ³ ,shkarkimi ne auto	Kategoria A	< 20	mil
		2.258	Nenshtrese zhavori ne themel			
		3.243	Beton C 16/20 per themelin e murit rrethues			
		2.117/1	Koloncina b/a monolite C - 16/20, h ~ 4 m			
		2.121/1	Brez b/a C 16/20, h ~ 8 m			
		2.65/2	Mur me tulle plota ne lartesi deri 8m me llaç perzier M 25			
		An	Kangjella metalike siper muri h=70cm			
		An	F.V. Porte metalike per hyrjen e varrezave (2x1.6m)			
		3.643	Mbjellje siperfaqe me bar			
		An167	F.V. Peme Qiparisi me d > 10 cm			
NS-18	18 Punime topogjeodezike	Te gjitha punimet e mesiperme				

(Shënim: përcaktoni kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ne baze te VKM-se Nr. 42 dt 16.01.2008 i ndryshuar.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- a. Inxhinier ndertimi 1 (nje)
- b. Inxhiner gjeodet 1 (nje)

Per kete duhet te paraqes Diplome, CV, kontrate pune te vlefshme, dhe të figuroj ne listëpagesen e shoqerise nga muaji Shtator 2022 e në vazhdim. Operatori ekonomik ploteson formularin permbledhes te vetedeklarimit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetedeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.3.4. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- a. 1 (nje) punonjes te pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ku njeri prej tyre te jete inxhinier Drejtues Teknik, ose shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë,
- b. 1 (nje) punonjes të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier “.

Per kete duhet te paraqes Diplome/Certifikate, CV, kontrate pune te vlefshme, dhe te figuroj ne listpagesen e shoqerise nga muaji Shtator 2022 e ne vazhdim. Ne fazen e ofertimit Operatori ekonomik ploteson formularin permbledhes te vetedeklarimit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- a. **Teknike ndertimi 1 (nje)** per kete duhet te paraqes diplomë, kontrate pune te vlefshme, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Shtator 2022 e ne vazhdim.
- b. **Karpiere 2 (dy)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Shtator 2022 e ne vazhdim.
- c. **Hekurkthyes 1(nje)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji nga muaji Shtator 2022 e ne vazhdim
- d. **Pllaka shtrues 2(dy)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji nga muaji Shtator 2022 e ne vazhdim
- e. **Puntore te thjeshte 7 (shtate)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji nga muaji Shtator 2022 e ne vazhdim.
- f. **Shofere 3 (tre)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, leje drejtimi, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji nga muaji Shtator 2022 e ne vazhdim. (Ne raste kur makinerit disponohen me qera, keta punonjes mund te jene te kontraktuar nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).
- g. **Manvratore 1 (nje)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme leje drejtimi, Deshmi Kualifikimi te Sigurimit teknik (IQT) (ose ekuivalente) dhe te figuroj ne ne listpagesen e shoqerise nga muaji Shtator 2022 e ne vazhdim. (Ne raste kur makinerit disponohen me qera, keta punonjes mund te jene te kontraktuar nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- diplome,
- kontrata pune,
- deshmi kualifikimi
- Ne raste kur makinerit disponohen me qera, keta punonjes mund te jene te kontraktuar nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.

(Shënim: listoni dokumentacionin provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, mbështetës dhe të specializuar/kualifikuar të kërkuar, dhe nëse është rasti kërkesat për licencat profesionale individuale, apo certifikimet/kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime/kualifikime).

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndertimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve te objektit qe prokurohet për secilin nga zërat e punimeve për ndërtimin e objektit, zbërthimin e projektit konstruktiv, punimet e betonit të hekurit, punimet e muraturës, shtresave të rruges etj. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve si psh të betonit, hekurit etj.
- **Inxhinieri gjeodet** është përgjegjës për zbatimin e saktë të kuotave te projektit object prokurimi për realizmin e sakte te kuotave dhe shtresave te rruges, kuotave te nenshtresave te rruges , dhe kuotave dhe dimensioneve të kanalizimit te ujrave te shiut ne trupin ose ne anet e rruges.
- **Teknike ndertimi** (ose ing ndertimi ne zbatim) është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve ne kantierin e projektit object prokurimi për realizmin e sakte te kuotave dhe shtresave te rruges, kuotave te nenshtresave, dhe kuotave dhe dimensioneve të kanalizimit te ujrave te shiut ne trupin ose ne anet e rruges.
- **Karpentiere** eshte pergjegjes per pergatijen e armatures se derrases dhe betonimin e sakte te strukturave beton dhe beton arme te perfshira ne objektin qe prokurohet
- **Hekurkthyesi** eshte pergjegjes per kthimin dhe lidhjen e sakte te hekurit dhe vendosjen e datajeve metalike ne strukturat b/a te perfshira ne objektin qe prokurohet.
- **Pllaka shtruesi** eshte pergjegjes per vendosjen e sakte te bordurave te parapergatitura apo te derdhura ne vend, per shtrimin e sakte te pllakave te parapergatitura per trotuaret e perfshira ne objektin qe prokurohet.
- **Shofere** jane personat pergjegjes per drejtimin e makinerive ne kantiar dhe jashte kantierit per furnizimin dhe transportin e materialeve te nevojshme per objektin qe prokurohet. Ne raste kur makinerit disponohen me qera, keta punonjes do te jene te kontraktuar.
- **Manovratore** jane personat pergjegjes per drejtimin e makinerive dhe pajijeve te ndertimit ne kantiar dhe jashte kantierit per kryerjen e proceseve te caktuara te puneve (psh. presa/pompa betoni,ekskavatore germim, mini fadroma, skrep te llojeve te ndryshme etj) te

nevojshme per objektin qe prokurohet. Ne raste kur makinerit disponohen me qera, keta punonjes do te jene te kontraktuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 19 (nëntëmbëdhjetë) persona**.

Periudha për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Referuar kategorise se punimeve si dhe afatit, stafi i kerkuar duhet te jete:

- | | |
|------------------------------|-------------------|
| • <i>Teknike ndertimi</i> | <i>1 (nje)</i> |
| • <i>Karpenriere</i> | <i>2 (dy)</i> |
| • <i>Hekurkthyes</i> | <i>1(nje)</i> |
| • <i>Pllaka Shtrues</i> | <i>2 (dy)</i> |
| • <i>Puntore te thjeshte</i> | <i>7 (shtate)</i> |
| • <i>Shofere</i> | <i>3 (tre)</i> |
| • <i>Manovratore</i> | <i>1 (nje)</i> |
| • <i>Drejtues Teknik</i> | <i>2 (dy)</i> |

TOTALI = 19 Persona ne Staf (netëmbëdhjetë).

Shenim: Argumetnimi i nr. te punonjeseve behet vetem me qellim per justifikimin e stafit te kerkuar. Ndarja sipas specialitetev ne kete rubrike te mos merret ne konsiderate ne plotesimin e kriterëve te percaktuara.

2.3.7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- | | |
|---|---------------------|
| • Kamion me aftesi mbajtese mbi/ose 18 ton | cope 2 (dy) |
| • Kamiocine me aftesi mbajtese (1.5 deri ne 3.5 ton) | cope 1 (nje) |
| • Miniekskavator | cope 1 (nje) |
| • Ekskavator me zinxhire | cope 1 (nje) |
| • Depozite uji mbi/ose 1000 litra | cope 1 (nje) |
| • Autobot uji | cope 1 (nje) |
| • Fadrome | cope 1 (nje) |
| • Betoniere | cope 2 (dy) |
| • Vibrator betoni | cope 1 (nje) |

• **Autovinc jo më pak se 5 ton**

cope1 (nje)

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtem:

- lejen e qarkullimit.
- certifikatat e pronësisë,
- siguracionin e mjetit.
- kolaudimin,
- certifikatë transporti
- fotografi të mjetit të paraqitura. (të cilat duhet të jenë në emër të shoqërisë ose në emër të qeradhënësit).

Për mjetet dhe pajisjet të cilat nuk kanë leje qarkullimi, Ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratë noteriale të blerjes,
- fatura tatimore të blerjes ose dokumenta zhdoganimit të mjetit.

Pranohet marrja me qera e mjeteve të mësipërme, me kusht që kontrata e qeramarrjes të jetë bërë para noterit, me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt.

- a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, , leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik , siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit,(të vlefshme) , të shoqëruar me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit noteriale,, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*
- b) *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- c) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës përkatëse. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Certifikat ISO:

- a) **ISO 9001-2015 – Standard per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise (e vlefshme) ose ekuivalente**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi:

Kjo çertifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

- b) **ISO 14001 - 2015 - Standard per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit (e vlefshme) ose ekuivalente**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi:

Kjo çertifikatë mundëson që shoqëria e cila punon/ushtron aktivitetin në një zonë prodhimi; e cila përfshin larminë e ajrit, tokës, ujit dhe burimeve natyrore, bimëve dhe kafshëve, dhe qeniet njerëzore dhe shoqërimin e tyre me njëri-tjetrin. Iso 14001 është standardi universal i procesit të monitorimit të përpjekjeve të një organizate drejt mjedisit të saj dhe në një kuptim tjetër të hapave përpara. Është një ndërveprim sistematik që lejon të zbatohet duke i kushtuar vëmendje efekteve rreth tij gjatë periudhës nga faza e parë e prodhimit deri te dorëzimi tek përdoruesit e këtij objekti, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

- c) **ISO 45001-2018 Standart per Menaxhimin e Shendetit dhe Sigurise ne Pune (e vlefshme) ose ekuivalente**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

Argumentimi:

Sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës mundëson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin

e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar), si dhe ne Kodin te punes, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Ligjin nr.10237 date 18.02.2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune", VKM nr. 562, datë 03.07.2013 “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës”, VKM nr. 563, datë 03.07.2013 "Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës”, VKM nr.312, datë 5.5.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier si dhe ne mbeshtetje te natyres se objektit te prokurimit.

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërishit çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

Specifikimet teknike janë bere per permbushjen e nevojave te Autoritetit Kontraktor. Materialet i kane specifikimet e tyre cilesore dhe sasiore sipas zerave te secilit ne preventive dhe ne specifikimet teknike.

Të gjitha materialet e përshkruara në preventiv duhet të jenë sipas specifikimeve teknike.

Në rast se një nga zërat e preventivit është e shkruar me emra marke automatikisht do të pranohet edhe një produkt ekuivalent.

Specifikimet teknike u hartuan nga **DREJTORIA E HARTIMIT TË PROJEKTEVE, MONITORIMIT TË INVESTIMEVE DHE TË SHËRBIMEVE** duke marr në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e nenit 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr.162/2020, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, e Nenit 40 pika 2, si edhe te Nenit 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **02/12/2022, ora 11:00.**

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “ **Ndërtim i Kuartallit të Ri në Varrezat e Qytetit**”

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

Dokumentat e tenderit.

NJESIA E PROKURIMIT: